

LIGJI NR. 06/L-118

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 05/L-075 PËR PARANDALIMIN DHE SANKSIONIMIN E DHUNËS DHE DUKURIVE NEGATIVE NË NGJARJET SPORTIVE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 05/L-075 PËR PARANDALIMIN DHE SANKSIONIMIN E DHUNËS DHE DUKURIVE NEGATIVE NË NGJARJET SPORTIVE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive.

Neni 2

Neni 16 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

Neni 16 Dënimet për personat juridikë

1. Me gjobë prej dymijë (2.000) euro deri në njëzetëmijë (20.000) euro, gjobitet për kundërvajtje federatat e sportit, klubet sportive, shoqëritë sportive ose personat e tjerë juridikë që organizojnë ngjarjet sportive, nëse nuk:

- 1.1. mundësojnë mbajtjen e sigurt të ngjarjes sportive të paraparë me nenin 3 të këtij ligji;
- 1.2. kanë kontroll për zbatimin e masave të parapara me nenin 3 të këtij ligji;
- 1.3. ndërmarrin masat preventive të parapara me nenin 8 të këtij ligji;
- 1.4. trajnojnë – aftësojnë ose nuk e angazhojnë shërbimin kujdestar adekuat;
- 1.5. bashkëpunojnë me Policinë e Kosovës;
- 1.6. gjatë mbajtjes së ngjarjes sportive nuk sigurojnë praninë e shërbimit mjekësor, dhe nuk bashkëpunojnë me organet kompetente;
- 1.7. gjatë mbajtjes së ngjarjes sportive nuk sigurojnë vende të veçanta për zyrtarët e organeve kompetente ose të organizatave, shërbimeve publike dhe zyrtarëve publikë të cilët kanë obligim që ta monitorojnë ngjarjen sportive;
- 1.8. shpallin me rrezikshmëri të lartë ngjarjen sportive përkatëse;
- 1.9. ndërmarrin masat përkatëse para, gjatë dhe pas ngjarjes sportive me rrezikshmëri të lartë sipas nenit 9 të këtij ligji;

1.10. sigurojnë mbajtjen e evidencave të parapara për shitjen e biletave të ngjarjes sportive me rrezikshmëri të lartë dhe nuk ia paraqesin ato Policisë së Kosovës sipas kërkesës zyrtare;

1.11. sigurojnë që për ngjarje sportive me rrezikshmëri të lartë biletat t'iu shiten vetëm personave që kanë dokumente identifikimi;

1.12. sigurojnë se një personi mund t'i shiten vetëm deri në shtatë (7) bileta;

1.13. sigurojnë se nuk u lejohet hyrja në objekt sportiv, gjatë kohës sa zhvillohet ngjarja sportive, personave më të ri se gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç, pa kujdesin e prindit ose kujdestarit ligjor;

1.14. sigurojnë nëse shitja e biletave bëhet në kundërshtim me kushtet e parapara me këtë ligj;

1.15. sigurojnë që ngjarja sportive të zhvillohet në objektin e përshtatshëm sportiv;

1.16. sigurojnë nëse shitet alkooli në objektin sportiv edhe përkundër ndalesës, dhe personat përgjegjës nuk e raportojnë atë tek organet kompetente.

Neni 3

Neni 17 i ligjit bazik, ndryshohet si në vijim:

Neni 17

Dënimet për personat fizikë

Për veprimet e kryera të cilat janë paraparë me nenin 4 të këtij ligji personi fizik dënohet me gjobë prej dyqind (200) euro deri në dymijë (2.000) euro.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L - 118

7 mars 2019

Shpallur me dekretin Nr. DL-82-2019, datë 25.03.2019 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi